



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në zbatim të nenit 50, pika 3, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në procedurën e vlerësimit të vlerës të një automjeti në pronësi të Autoritetit, që do të shitet përmes procedurës së ankandit publik.

TERMAT E REFERENCËS

Detyrat

- Në zbatim të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik”, i ndryshuar, vendimit nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, eksperti do të angazhohet në bashkëpunim me stafin e AMA-s, në procedurën e vlerësimit të vlerës të një automjeti në pronësi të institucionit, që do të shitet përmes procedurës së ankandit publik.
- Të përmbushë shërbimin e vlerësimit në përputhje me standartet profesionale, me kompetencë, pavarësi dhe etikë profesionale.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 10 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të zotërojë licencë profesionale individuale për vlerësimin e pasurive të luajtshme në fushën “Linja teknologjike, makineri e pajisje” (LTMP) shkalla I;
2. Të ketë kryer punë të ngjashme;
3. Të jetë shtetas/e shqiptar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. Kopje të noterizuar të licencës (LTMP) shkalla I;
2. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme për të njëjtin objekt vlerësimi (kontrata, akt vlerësime etj).
3. Jetëshkrim/CV;
4. Kopje ID/Pasaportë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Eksperiencia në punë: 70 pikë
2. Jetëshkrimi: 30 pikë

APLIKIMET MBYLLEN NË DATËN 04.05.2021, ora 11:00

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jsthtë të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në adresën “Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 20.04.2021